

FJALA E DEPUTETIT ENKELEJD ALIBEAJ

E ENJTE 28 PRILL 2022

Tha trembëdhjetë herë fjalët: budalla, i budallenjve, kopeja e me radhë. Të them të drejtën, ndjej keqardhje për gjendjen e tij mendore, por në këtë parlament ka ca rregulla. Kemi një Kod të Sjelljes, zonja Kryetare e Kuvendit, dhe Kodi i Sjelljes, i miratuar nga ky Kuvend, në nenin 6 thotë: “Duhet sanksionuar deputeti, i cili përdor gjuhë joparlamentare.”. Dhe sapo ndodhi. Duhet sanksionuar nga ju, pavarësisht se është ulur aty, poshtë jush, për të vendosur seriozitetin në këtë sallë.

Pastaj, për historinë e budallenjve apo të hajdutëve, këtu mund të jenë edhe shumë të rinj, që mbase dikur, kur zotëria ishte ministër i Kulturës, dhe ai e mban mend, ka një të dhënë të dokumentuar në analet e këtij Kuvendi. Kur ky ishte ministër, mori ikonat dhe i çoi në Gjermani, prej nga nuk u kthyen kurrë këtu.

Për procedurë do të them tani edhe gjënë tjetër: për të kthyer seriozitetin e diskutimit në këtë sallë dhe për të folur për ato gjëra, të cilat u interesojnë shqiptarëve, jo budallenjve, siç pretendon t’i trajtojë ai, do të flasë zonja Ina Zhupa. Faleminderit zonjë! Pres nga ju, që të merrni masën e sanksionit në lidhje me gjuhën joparlamentare të përdorur nga deputeti Rama. Ka vetëm një justifikim: nëse i mungon diçka, ajo është gjendje mendore e rënduar. Vetëm kjo mund ta shpëtojë nga sanksioni. Faleminderit!

Sipas Rregullores së Kuvendit, sa herë që flet Kryeministri, do të duhet që kryetari i grupit parlamentar të partisë më të madhe opozitare të përgjigjet në të njëjtën kohë; ose ai vetë, ose një nga kolegët e tij të deleguar. Unë delegova zonjën Ina Zhupa. A mund t’ia jepni fjalën, sipas Rregullores?